

Përmbledhje e projektit



**BASHKËPUNIMI ME SIPËRMARRJEN
DHE ZGJIDHJET PËR SDG-të**

Objektivi

Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) është një projekt i përbashkët i Kombeve të Bashkuara (UNJP) me objektiv rritjen e numrit të sipërmarrjeve shqiptare që zbatojnë praktika biznesi të qëndrueshme, duke krijuar një ndikim pozitiv në mjedis dhe në shoqëri, si dhe duke kontribuar njëkohësisht në rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse në Shqipëri.

Buxheti 4 milionë dollarë amerikanë (USD)

Donatori Ambasada e Suedisë

Kohëzgjatja Janar 2024 - Dhjetor 2027

Përfituesit

Sipërmarrjet shqiptare dhe komuniteti i biznesit

Partnerët

Qeveria qendrore dhe vendore, shoqatat e sektorit, akademia, bizneset suedeze dhe ndërkombëtare

Agjencitë zbatuese



Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë



ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIMIN INDUSTRIAL

Konteksti

Sektori privat në Shqipëri ka udhëhequr zhvillimin e vendit, duke përmirësuar statusin e Shqipërisë në atë të një vendi me të ardhura mesatare, gjatë 25 viteve të fundit. Megjithatë, në përgjithësi, sipërmarrjeve shqiptare u mungojnë njohuritë rreth SDG-ve, si dhe rreth ndikimeve të tyre mjedisore dhe sociale. Aplikimi i SDG-ve u jep bizneseve shqiptare mundësinë që të rrisin qëndrueshmërinë dhe të fitojnë një avantazh strategjik, veçanërisht duke pasur parasysh sfidat aktuale si kriza energjetike, inflacioni, mangësitë në burime dhe mungesa e fuqisë punëtore. Përditësimet e rregulloreve për eksportet, riciklimin dhe gjurmueshmërinë, mund të mbështesin akoma më tej rritjen e qëndrueshme. Faza pilot e projektit u fokusua në sektorët e agro-përpunimit dhe të tekstileve, duke krijuar një rrjet që do të zgjerohet në mbarë Shqipërinë në fazën e dytë dhe aktuale të tij.

Në vijim të suksesit gjatë fazës pilot (2022-2023), projekti po zgjeron punën e tij përmes aspekteve në vijim:



Kapacitete teknike

Sipërmarrjet do të pajisen me kapacitete teknike për të zbatuar praktikat e qëndrueshme dhe për të kontribuar në zinxhirët e vlerës në nivel vendor.



Ekosistem mbështetës

Sipërmarrjet janë në dijeni të rëndësisë së qëndrueshmërisë, janë të lidhura me komunitetin e biznesit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe nxisin politikëbërësit për hartimin e politikave mbështetëse.

Grupet e synuara



Përfituesit kryesorë janë sipërmarrjet shqiptare të sektorëve dhe madhësive të ndryshme, duke përfshirë pronarët dhe fuqinë punëtore.



Grupe të posaçme të synuara janë bizneset e drejtuara nga të rinjtë dhe nga gratë, si dhe bizneset e drejtuara nga individë të grupeve të disavantazhuara apo që punësojnë individë nga këto grupe (si p.sh. komunitetet Rome/Egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara).



Institucionet vendore dhe qendrore janë aktivisht të angazhuara dhe funksionojnë si partnerë për të ndihmuar në aspektet e informimit dhe të përfshirjes.



Shoqatat e sektorit, dhomat e tregtisë, kompanitë ndërkombëtare, universitetet dhe institucionet financiare përbëjnë grupet kryesore të interesit.



Politikëbërësit përfitojnë nga dialogët mbi politikat dhe takimet informuese të posaçme (ad-hoc) për të mbështetur praktikën e qëndrueshme në bizneset shqiptare.

Rezultati 1: Kapacitete teknike

- Produkti 1:** Përmirësimi i kapaciteteve të sipërmarrjeve vendase për sa i përket efikasitetit të energjisë dhe të burimeve.
- Produkti 2:** Mbështetja e sipërmarrjeve vendase për të përmirësuar administrimin e biznesit, për të krijuar praktika çarkulluese në përputhje me standardet e BE-së, si dhe për të përmirësuar marrëdhëniet me blerësit dhe me furnitorët.
- Produkti 3:** Akses në trajnime për sipërmarrjet në sektorët e synuar për të përmirësuar produktivitetin dhe aspektet sociale të administrimit të biznesit.
- Produkti 4:** Mbështetja e fermave të përzgjedhura për të përmirësuar praktikën bujqësore dhe për të zhvilluar udhëzime për bujqësinë inteligjente ndaj klimës.

Rezultati 2: Ekosistem mbështetës

- Produkti 5:** Lehtësimi i tregtisë ndërkombëtare për sipërmarrjet në Shqipëri përmes lidhjes me bizneset dhe mundësitë për financim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u fokusuar te Suedia.
- Produkti 6:** Përmirësimi i njohurive të politikëbërësve në nivel kombëtar dhe vendor rreth SDG-ve dhe praktikave të qëndrueshme të lidhura me sektorin privat.
- Produkti 7:** Promovimi i SDG-ve dhe praktikave të qëndrueshme në komunitetin e biznesit dhe te konsumatorët përmes fushatave të komunikimit dhe aktiviteteve të posaçme.

Ndikimi

Projekti “Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për SDG-të” (Business4SDGs) ka si objektivi të lehtësojë tranzicionin e sipërmarrjeve shqiptare drejt praktikave të qëndrueshme. Përmes masave të tij, ky projekt do të kontribuojë për të konkretizuar ndikimin pozitiv të sektorit privat te mjedisi dhe shoqëria, si dhe kontributin e tij në rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse të vendit.

Prioritetet kyçe për vitin 2025

- 1- Përfundimi i vlerësimeve “SCORE” dhe “RECP” të 30 ndërmarrjeve në kuadër të programit të ILO-UNIDO “Zgjidhje inovatore për ndërmarrje eficiente dhe të qëndrueshme në sektorët e tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe veshjeve të këmbës (TVLVK)” (Programi ISES).**
- 2- Organizimi i seminareve për të validuar 2 raportet që përcaktojnë problematikat dhe mundësitë në sektorët e TVLVK-së, si dhe i një ankete mbi nevojat e sipërmarrjeve në sektorët e TVLVK-së.**
- 3- Publikimi i Kodit të Praktikës të ILO-s: Siguria dhe shëndeti në sektorin e tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe veshjeve të këmbës, i përshtatur për Shqipërinë.**
- 4- Prezantimi i trajnimit të parë, publikimi i vlerësimeve “RECP” të UNIDO-s për bizneset e agro-përpunimit dhe lançimi i mekanizmit të mbështetjes për RECP-në (burime efikase dhe prodhim më i pastër).**
- 5- Prezantimi i metodologjisë së UNDP-së “Të rritesh me biznesin tënd” në bashkitë strategjike.**
- 6- Organizimi i edicionit të 2-të të Konferencës “Biznesi #2030” dhe i edicionit të 3-të të Çmimit “SDG Business Pioneers” (Vlerësimi i Sipërmarrjeve të Qëndrueshme).**
- 7- Krijimi një platforme online B2B për vendosjen e lidhjeve me qëllim ndërkombëtarizimin e sipërmarrjeve.**
- 8- Anketë e inteligjencës së tregut lidhur me pikëpamjet e drejtorëve ekzekutivë (CEO) dhe konsumatorëve mbi qëndrueshmërinë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të politikëbërësve.**
- 9- Lançimi i metodologjisë “SDG Demo Farms (Fermat model të SDG-ve)”, i zhvilluar bazuar në të dhënat e gjeneruara përmes vlerësimit të FAO-s me titull “Zinxhiri i Vlerës për Ushqim të Qëndrueshëm (SFVC)”, për zinxhirët e priorizuar të vlerës.**
- 10- Zbatimi i një programi trajnimi që synon ofruesit e shërbimeve të ekstensionit, fermerët dhe NVM-të bujqësore, me fokus te praktikën e qëndrueshme, investimet e harmonizuara me SDG-të, njohuritë financiare dhe administrimi i biznesit, i cili do të ofrohet përmes modalitetit “Aftësimi Praktik i Fermerëve” (Farmer Field School, FFS).**
- 11- Akses më i lehtë i fermerëve dhe NVM-ve bujqësore në kreditë e ofruara nga institucionet financiare tregtare për të financuar investimet për përmirësimin e modeleve të biznesit, shoqëruar me asistencë teknike të posaçme në aspektin e ofertës.**
- 12- Fushata të vazhdueshme komunikimi dhe aktivitete demonstrimi për të rritur ndërgjegjësimin e bizneseve dhe te konsumatorëve mbi qëndrueshmërinë.**
- 13- Krijimi i bashkëpunimeve dhe zhvillimi i aktiviteteve që lidhin NVM-të e synuara me ekosistemin më të gjerë me qëllim forcimin e lidhjeve të tyre me tregun.**